



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILI KOMBËTAR I UJIT

Nr. 335 Prot .

Tiranë, më 25 . 5 .2018

V E N D I M

Nr. 1 , datë 9.5 . 2018

PËR

**SHFUQIZIMIN PJESËRISHT TË VENDIMIT NR. 12, DATË
26.10.2016, TË KËSHILLT KOMBËTAR TË UJIT, "PËR
MIRATIMIN E LEJES "PËR PËRDORIM BURIMI UJOR", PËR
PRODHIM HIDROENERGJIE, PËR HEC-ET "BIGAS 1",
"BIGAS 2", "VELESHNJË", ME VENDNDODHJE: PELLGU
UJËMBLEDHËS I PËRROIT BIGAS DHE I PËRROIT
VELESHNJË, NJËSITË ADMINISTRATIVE POTOM, ÇEPAN,
BASHKIA SKRAPAR, QARKU BERAT"**

Në mbështetje të pikës 6, të nenit 50, shkronjës "e", të nenit 55, të ligjit nr.111/2012, datë 15.11.2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të ndryshuar, shkronjës "d", të nenit 109, nenit 113, të Kodit të Procedurave Administrative, me propozimin e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit, Këshilli Kombëtar i Ujit

V E N D O S I:

1. Shfuqizimin pjesërisht të vendimit nr.12, datë 26.10.2016, "Për miratimin e lejes për përdorim burimi uhor", për prodhim hidroenergjie, për HEC-et "Bigas 1", "Bigas 2", "Veleshnjë", me vendndodhje: Pellgu ujëmbledhës i përroit Bigas, Njësitë Administrative Potom, Çepan, Bashkia Skrapar, Qarku Berat", për HEC-et "Bigas 1" dhe "Bigas 2".
2. Ngarkohet Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

SENIDA MESI

